



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6623/Prot.
1

Tiranë, më 18.11.2021

UDHËZIM

Nr. 22, datë 18.11.2021

PËR

**ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË NXËNËSVE TË KLASAVE TË
BASHKUARA II-IX TË ARSIMIT BAZË, 2021**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “a” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” dhe vendimit nr. 523, datë 22.09.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II-IX të arsimit bazë, më datë 6 dhjetor 2021.
2. Testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II-IX të arsimit bazë është një vlerësim i njohurive gjuhësore në leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe dhe të njohurive matematikore.
3. Testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II-IX, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 60 minuta.
4. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) caktojnë numrin e administratorëve përgjegjës për zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II-IX për çdo institucion arsimor parauniversitar, ku do të zhvillohet testimi.
5. Në çdo ZVAP, procesi i testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II-IX monitorohet nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).
6. DPAP monitoron procesin e tërheqjes dhe shpërndarjes së materialeve të provimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në ZVAP-et përkatëse një ditë para zhvillimit të testimit.
7. QSHA kryen detyrat si më poshtë:

- a) harton testin e standardizuar dhe skemën e vlerësimit;
 - b) shumëfishon dhe paketon të gjitha materialet e testimit dhe bën shpërndarjen e tyre;
 - c) përpunon të dhënat, përgatit raportin mbi arritjet e nxënësve në testim dhe ia paraqet atë ministrit të Arsimit dhe Sportit.
8. DRAP/ZVAP kryen detyrat si më poshtë:
- a) dërgon në QSHA listën e institucioneve arsimore parauniversitare që kanë klasa të bashkuara dhe numrin e nxënësve për çdo klasë;
 - b) tërheq nga QSHA materialet e testimit një ditë përpara zhvillimit të testimit;
 - c) udhëzon administratorët përgjegjës të çdo institucioni arsimor të caktojnë administratorët e testimit për çdo klasë dhe të menaxhojnë në kohë shpërndarjen dhe grumbullimin e testeve të nxënësve;
 - d) organizon dhe kryen procesin e vlerësimit të testeve. Të dhënat dërgohen në formë elektronike në QSHA, DPAP dhe MAS deri në datën 23 dhjetor 2021;
 - e) mban përgjegjësi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e testeve deri në përfundim të procesit;
 - f) kryen pagesën e vlerësuesve të testeve sipas legjislacionit në fuqi.
9. Udhëzimi nr. 3, datë 12.02.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II-IX të arsimit bazë 2019”, shfuqizohet.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, DRAP-et dhe ZVAP-et, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Evis KUSHI

